

28.03.2017
NË EMËR TË POPULLIT



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetarin e trupit gjykues Agim Maliqi dhe me procesmbajtësen Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I nr. 162/2016 e datës 23.12.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 07 shkurt 2017, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Florije Shamolli dhe të pandehurit, të njëjtën datë mori dhe komunikoi, kurse me datë 09 shkurt 2017 përpiloj me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] i gjinisë [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED] – [REDACTED] me vendbanim në [REDACTED] rr. "[REDACTED] [REDACTED]" nr. [REDACTED], ndërtesa te [REDACTED], kati [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, numri personal [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në "[REDACTED] [REDACTED]", i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 01.11.2016, rreth orës 21:55 në Ferizaj në rr. "[REDACTED] [REDACTED]", në dalje të banesës së tij ka poseduar armët në kundërshtim me ligjin mbi armët, në atë mënyrë që me rastin e kontrollës nga ana e policisë në trupin e tij, i janë gjetur një revole e tipit Parabellum me karikator dhe me dy copë fishek dhe një pako me katërdhjetë e tre (43) fishekë të cal. 9mm., gjithashtu edhe në veturën e tij BMW me ngjyrë të bardhë iu ka konfiskuar revolva e tipit Ecol M92 me karikator me 7 copë fishek, të cilat pastaj iu kanë sekuestruar nga policia.

- me të cilën ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së

Andaj Gjykata në bazë nenit 374 par.1 dhe neneve 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPP-ës, e

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË NË SHUMËN PREJ 600 /gjashtëqind/€, të cilën shumë është i obliguar që të paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimit të merr formën e prerë.

Nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 41par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro do të vuaj nga një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 /pesëdhjetë/ €, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Në kuptim të nenit 374 par. 3 të KPK-ës konfiskohet në mënyrë të përhershme një revole e tipit Parabellum me karikator dhe me dy copë fishek dhe një pako me katërdhjetë e tre (43) fishekë të cal. 9mm dhe revolva e tipit Ecol M92 me karikator me 7 copë fishek.

A r s y e t i m i

1. Historiku procedural

Prokuroria e Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.I.nr.162/2016, të datës 23.12.2016, ka akuzuar [REDAKTUAR], për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Kryetari i trupit gjykues duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 07 shkurt 2017, në të cilën i pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Deklarimi i të pandehurit është vlerësuar se i plotëson kushtet nga neni 248 par. 1 të KPPK-së pasi që i pandehuri ka kuptuar:

- natyrën dhe pasojat pranimit të fajësisë;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- aktakuza mbështetet në faktet dhe në provat e çështjes siç janë mbrojtja e të pandehurit, vërtetimi për konfiskimin e armëve dhe fotografitë e armëve, të cilat prova janë siguruar gjatë procedurës hetimore;
- se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, andaj kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

3. Analiza e Ligjit Material

Trupi gjykues vlerësoj se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, meqë i akuzuari me dashje direkte në vend, datë dhe kohë e përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ka poseduar një revole e tipit Parabellum me karikator dhe me dy copë fishek dhe një pako me katërdhjetë e tre (43) fishekë të cal. 9mm dhe revolja e tipit Ecol M92 me karikator me 7 copë fishek.

4. Vlerësimi i dënimit të shqiptuar

Trupi gjykues më rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK-së.

Si rrethanë lehtësuese mori, pranimin e fajësisë që në seancën fillestare se i akuzuari më parë nuk ka rënë në konflikt me ligjin, përkatësisht nga të dhënat e evidencës penale nuk rezulton se është dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe këto rrethana i ndërliði me rrethana tjera personale se është i martuar baba i tre fëmijëve, ndërsa nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e shqiptuar është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPK-ës, se edhe me anë të këtij

dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.

4. Konfiskimi dhe shpenzimet procedurale

Konform nenit 374 par.3 të KPK-ës Gjykata në mënyrë të përhershme konfiskoi një revole e tipit Parabellum me karikator dhe me dy copë fishek dhe një pako me katërdhjetë e tre (43) fishekë të cal. 9mm dhe revolja e tipit Ecol M92 me karikator me 7 copë fishek, meqë me dispozitën përkatëse është përcaktuar konfiskimi i obliguar.

Gjykata konform nenit 450 par.2 pika 6 të KPPK-së, i caktoi shpenzimet paushalle në lartësi prej 50/pesëdhjetë/€, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, PKR.nr.194/16 më 09 shkurt 2017

Sekretarja juridike,
Albana Ajvazi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,

Agim MALIQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.